

ManeTCI Sh.p.k

**Pasqyrat financiare
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
me raportin e audituesit të pavarur**

Përmbajtja

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR.....	1
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE	2
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL.....	3
PASQYRA E FLUKSIT TË PARASË	4
1. Informacion i përgjithshëm	5
2. Bazat e përgatitjes.....	5
3. Gjykime të rëndësishme kontabël, çmuarjet dhe vlerësimet	5
3. Gjykime të rëndësishme kontabël, çmuarjet dhe vlerësimet (vazhdim).....	6
4. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël	6
4.1 Korigjimi i gabimeve.....	13
5. Standarde të reja dhe amendimet.....	14
6. Aktive afatgjata materiale	18
7. Aktivet afatgjata te investimit	19
8. Aksione dhe pjesmarrje te tjera ne njesite e kontrolluara.....	19
9. Kredi me interes dhe huadhenje afatgjata	19
10. Aktive afatgjata financiare, neto	19
11. Inventari	19
12. Kredi me interes dhe huadhenje afatshkurter	20
13. Të drejta të arkëtueshme.....	20
14. Aktive afatshkurter te tjera.....	21
15. Tatim fitimi i parapaguar.....	21
16. Mjete monetare dhe të ngjashme.....	21
17. Kredi me interes dhe huamarrje	22
18. Kapitali aksionar	22
19. Rezerva	22
20. Detyrime te tjera financiare.....	23
21. Parapagime.....	23
22. Llogari te pagueshme.....	23
23. Te pagueshme te tjera.....	23
24. Dividend i pagueshem	23
25. Te ardhura nga shitja e pronave	24
26. Te ardhura nga shitja e punimeve dhe mirembajtja.....	24
27. Te ardhura te tjera	24
28. Te ardhura nga shoqerite e kontrolluara	24
29. Blerje e materialeve	24
30. Blerje e sherbimeve.....	25
31. Shpenzime administrative	25
32. Shpenzime personeli	25
33. Shpenzime provigjioni	25
34. Totali shpenzime financiare, neto.....	26
35. Humbja nga kursi kembimit,neto.....	26
36. Tatimi mbi fitimin.....	26
37. Palet e lidhura	27
38. Menaxhimi i rrezikut Financiar	28
40. Raportimi i vlerës së drejtë.....	31
41. Angazhime dhe detyrimet e kushtëzuara	31
42. Ngjarjet pas datës së bilancit.....	32

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtimit dhe Aksionarit të ManeTCI Sh.p.k.

Opinion me rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të ManeTCI sh.p.k. (më poshtë "Shoqëria"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2017, si dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse, të ndryshimeve në kapital dhe të flukseve të parasë për vitin që mbyllet më këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare të veçanta, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjeve të parashikuara në seksionin e *Bazës për Opinionin me Rezervë* të raportit tonë, pasqyrat financiare paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2017, dhe performancën e saj financiare dhe të flukseve të parasë për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

Baza për Opinionin me Rezervë

Vlera e inventarit të pronave të Shoqërisë përfshin kostot e përgjithshme të infrastrukturës të alokuara në cdo pronë. Këto kosto janë kryer gjatë viteve 2009 deri në 2016 dhe vlera e mbetur në inventarin e pronave ende të pashitura më 31 dhjetor 2017 është 828 milion Lek (2016: 1,434 milion Lek). Gjatë procedurave tona të auditimit për të vlerësuar efektin e gjendjeve të vitit paraardhës mbi vitin ushtrimor, ne nuk arritëm të sigurojmë evidencë të mjaftueshme për këtë shumë. Për rrjedhojë, ne nuk ishim në gjendje të përcaktonim nëse do të ishte nevoja të bëhej ndonjë rregullim për vlerën kontabël më 31 dhjetor 2016 dhe efektin e tyre më 31 dhjetor 2017.

Meqënëse çeljet e inventarit përfshihen në përcaktimin e fitimit kontabël të vitit, ne nuk jemi në gjendje të përcaktojmë nëse është e nevojshme të bëhen korrigjime në fitimin e vitit 2017 dhe kostos së inventarit më 31 dhjetor 2017 në lidhje me këto kosto të alokuara të infrastrukturës.

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin *Përgjegjësia e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të veçantë* të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me *Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël* (Kodi i "BSNEPK") së bashku me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri (Kodi IEKA), dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe të Kodit BSNEPK.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin që mbyllet më datën 31 dhjetor 2016, janë të audituara nga një auditues tjetër i cili ka shprehur një opinion të pa modifikuar më 31 mars 2017. Ne nuk shprehim opinion mbi këto pasqyrave financiare apo mbi krahasueshmërinë e tyre me vitin ushtrimor.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që Drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA- të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e ManeTCI Sh.p.k. përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ernst & Young Ekspertë Kontabël të Autorizuar,
Dega në Shqipëri

Ernst & Young

8 tetor 2018
Tiranë, Shqipëri



Mario Vangjeli
Ekspert Kontabël i Regjistruar

Mario Vangjeli

ManeTCI Sh.p.k.

*Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
(të gjitha shumat janë të shprehura në mije Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)*

**PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
më 31 dhjetor 2017**

		<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u> <i>*rideklaruar</i>
AKTIVE	Shënimi		
Aktive afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	6	193,848	134,556
Aktive afatgjata investimi	7	-	-
Aksione dhe pjesëmarrje të tjera në njesite e kontrolluara	8	2,940,402	4,050,925
Kredi me interes dhe huadhenie afatgjata	9	35,941	-
Aktive afatgjata financiare	10	496,308	228,662
Inventari	11	288,221	-
Total - Aktive aftagjata		3,954,720	4,414,143
Aktive afatshkurtra			
Inventari	11	3,621,336	4,184,676
Kredi me interes dhe huadhenie afatshkurter	12	391,752	2,028
Te drejta të arketueshme	13	813,092	852,378
Aktiv tatimor i shtyre	36	10,918	13,046
Aktive afatshkurter të tjera	14	156,772	74,498
Tatim fitimi i parapaguar	15	85,596	-
Mjete monetare dhe të ngjashme	16	293,115	102,216
Total - Aktive afatshkurtra		5,372,581	5,228,842
TOTAL AKTIVE		9,327,301	9,642,985
KAPITALI DHE DETYRIMET			
Kapitali aksionar	18	689,750	689,750
Rezerva ligjore		756	756
Rezerva të tjera	19	2,891,588	2,596,074
Fitim i mbartur		411,245	794,875
Total – Kapitali		3,993,339	4,081,455
Detyrime afatgjata			
Kredi me interes dhe huamarrje	17	223,848	380,040
Detyrime të tjera financiare	20	489,045	286,667
Parapagime	21	2,299,422	2,132,814
Total - Detyrime afatgjata		3,012,315	2,799,521
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregëtare	22	898,216	1,148,775
Te pagueshme të tjera	23	9,473	17,065
Kredi me interes dhe huamarrje	17	1,004,718	527,098
Detyrime të tjera financiare	20	409,240	518,204
Dividend i pagueshem	24	-	501,596
Tatim fitimi i pagueshem	36	-	49,273
Total - Detyrime afatshkurtra		2,321,647	2,762,011
Total - Detyrime		5,333,962	5,561,532
TOTAL KAPITALI DHE DETYRIMET		9,327,301	9,642,987

Politikat kontabël dhe Shënimet nga faqja 5 deri në faqen 32 janë pjesë përbërëse, dhe duhet të lexohen së bashku me këto pasqyra financiare.

PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

Shënimi	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2016 *rideklaruar	
Të ardhura nga shitja e pronave	25	1,905,839	2,703,946
Te ardhura nga shitja e punimeve dhe mirembajtja	26	748,234	613,836
Te ardhura nga aktiviteti		2,654,073	3,317,782
Të ardhura të tjera	27	125,040	11,994
Të ardhura nga shoqerite e kontrolluara	28	178,749	264,448
Totali të ardhurave		2,957,862	3,594,224
Kosto e inventarit prone te shitur		(1,504,092)	(2,094,205)
Blerje e materialeve dhe punimeve	29	(415,431)	(352,350)
Blerje e sherbimeve	30	(121,538)	(67,389)
Shpenzime administrative	31	(104,758)	(70,208)
Amortizimi	6	(31,227)	(29,205)
Shpenzime personeli	32	(124,834)	(95,864)
Shpenzime provigjioni	33	(160,023)	(15,229)
Fitimi operacional		495,959	869,774
Te ardhura financiare		3,764	24,088
Shpenzime financiare		(34,703)	(21,469)
Totali shpenzime financiare, neto	34	(30,939)	2,619
Humbja nga kursi kembimit, neto	35	6,594	20,082
Humbja nga shitja e njesive te kontrolluara		-	(344)
Fitimi para tatimit		471,614	892,131
Tatimi mbi fitimin	36.2	(62,497)	(101,300)
Tatim fitimi i shtyrë	36.1	2,128	4,044
Fitimi neto per periudhën		411,245	794,875
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		411,245	794,875

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Drejtimi i Shoqërisë më 26 shtator 2018 dhe janë firmosur nga:

Arben Memo
Administrator

Vjola Kambellari
Drejtore e Departamentit të Financës

Arben Memo

Vjola Kambellari

Politikat kontabël dhe shënimet nga faqja 5 deri ne faqen 32 janë pjesë përbërëse, dhe duhet të lexohen së bashku me këtë pasqyrë financiare.



ManeTCI Sh.p.k.

*Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2017
(të gjitha shumtat janë të shprehura në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)*

**PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL
më 31 dhjetor 2017**

	Kapital i nëshkruar	Rezerva ligjore	Rezerva te tjera	Fitim i mbartur	Totali
Gjendja më 1 janar 2016	689,750	756	2,596,074	501,596	3,788,176
Shperndarje dividendi	-	-	-	(501,596)	(501,596)
Fitim i periudhes	-	-	-	794,875	794,875
Gjendja më 31 dhjetor 2016	689,750	756	2,596,074	794,875	4,081,455
Rritje ne rezerva te tjera	-	-	295,514	(295,513)	-
Shperndarje dividendi	-	-	-	(499,362)	(499,362)
Fitim i periudhes	-	-	-	411,245	411,245
Gjendja më 31 dhjetor 2017	689,750	756	2,891,588	411,245	3,993,339

Politikat kontabël dhe Shënimet nga faqja 5 deri ne faqen 32 janë pjesë përbërëse, dhe duhet të lexohen së bashku me këto pasqyra financiare

ManeTCI Sh.p.k.

Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
(të gjitha shumat janë të shprehura në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

**PASQYRA E FLUKSIT TË PARASË
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

	Shënimi	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2016 *rideklaruar
Aktivitetet e shfrytëzimit			
Fitimi pas tatimit		411,245	794,875
<i>Rregullime për të rakorduar humbjen neto me fluksin neto të parasë</i>			
Amortizime dhe zhvlerësime	6	31,227	29,205
Zhvlerësime për borxhin e keq	33	160,023	15,229
Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		(737)	(439)
Te ardhura nga interesat	34	(3,764)	(24,088)
Shpenzime per interesa	34	30,259	19,956
Dividendet e arketuar	28	(178,749)	(264,448)
Tatim fitimi	36	60,369	97,256
Fitim nga vleresimi investimeve	7	(104,386)	-
Rregullime per kapitalin qarkullues:			
Pakesim në inventare		432,967	1,423,120
(Rritje)/ pakesim në llogari të arkëtueshme dhe te tjera		(407,966)	251,405
Rritje/ (pakesim) në llogari të pagueshme dhe te tjera		111,437	(3,527,618)
Mjetet monetare neto të përfituara nga aktivitetet e shfrytëzimit		541,925	(1,185,547)
Tatim fitim i paguar		(163,105)	(29,382)
Mjetet monetare neto të përfituara nga aktivitetet e shfrytëzimit		378,820	(1,214,929)
Aktivitetet e investimit			
Blerje e shoqërisë së kontrolluar minus parate e arketuara		-	16,842
Blerje (shitje) aktivesh afatgjata materiale		(89,782)	51,239
Dividendet e arketuar	28	178,749	264,448
Mjetet monetare neto të përfituara/(përdorura) nga aktivitetet investuese		88,967	332,529
Aktivitetet financuese			
Te ardhura nga emetimi i kapitalit aksionar		-	-
Huadhënie		(571,821)	(2,028)
Huamarrje		321,428	784,189
Interes i paguar	34	(30,259)	(19,956)
Interesi i arketuar	34	3,764	24,088
Mjetet monetare neto përdorur në aktivitetet financuese		(276,888)	786,293
Rritje/(Pakesim) neto e mjeteve monetare		190,899	(96,107)
Mjetet monetare në fillim të periudhës	16	102,216	198,323
Mjetet monetare në fund të periudhës	16	293,115	102,216

Politikat kontabël dhe Shënimet nga faqja 5 deri ne faqen 32 janë pjesë përbërëse, dhe duhet të lexohen së bashku me këto pasqyra financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "MANE TCI" sh.p.k. është krijuar me date 25 Prill 2002 me Vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë Tirane me Nr. 27647 dhe është regjistruar në regjistrin e Shoqërive Tregëtare në të njëjtën ditë, me kapital të nënshkruar prej 500,000 leke, i cili është rritur në vite dhe me 31.12.2016 është 689,750,000 leke.

Deri në Janar të vitit 2009 ortak i vetëm i shoqërisë ka qenë Z. Samir Mane. Me pas kuotat e kapitalit i kaluan shoqërisë BALFIN shpk me NIPT K72223031K me ortak të vetëm Z. Samir Mane.

Objekt i veprimtarisë së shoqërisë është: Ndertimi, investimi në pronë të paluajtshme, qeradhenia, tregtimi i mallrave me shumicë dhe pakice, import-eksport, etj, sipas objektivit të veprimtarisë të përcaktuar në vendimin e gjykatës së Tiranës.

Selia e shoqërisë ndodhet në Njesinë Bashkiake Nr. 2, Rr. "Dervish Hima", Pallati Ambasador 3, kati 8, Ap. Nr. 3 dhe 4 Tirane. Më 31 dhjetor 2017 shoqëria ka të punësuar 146 punonjës (2016: 116 punonjës). Administratori i shoqërisë është Z. Arben Memo.

2. Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF"), të publikuara nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve Kontabël ("BNSK").

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike. Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në Lek shqiptar ("Lek"), e cila është edhe monedha funksionale e Shoqërisë si rrjedhojë e mjedisit ekonomik ku ajo operon, dhe të gjitha vlerat janë rrumbullakosur në Lek, përveç aty ku shprehet ndryshe.

Drejtimi i Shoqërisë ka kryer një vlerësim të aftësisë për të vazhduar aktivitetin në vijimësi dhe vlerëson që Shoqëria ka burime dhe perspektive për të vazhduar biznesin dhe aktivitetin në të ardhmen. Gjithashtu drejtimi nuk është në dijen të ndonjë paisjeje materiale që mund të sjellë dyshime të kosniderueshme mbi mundësinë e shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Prandaj, pasqyrat financiare vazhdojnë të përgatiten në baze të parimit të vijimësisë.

Kompesimi (netimi)

Aktivitetet dhe detyrimet financiare janë të kompensuara me njëra tjetrën dhe vlera neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm nëqoftëse është e drejtë ligjore për të kompensuar shumën e njohur dhe ka një synim për t'i mbyllur ato mbi një bazë neto, ose të realizojë aktivitetet dhe të shlyejë detyrimet njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet nuk janë kompensuar në pasqyrën e të ardhurave, përveç rasteve kur kërkohet ose lejohet nga ndonjë standard kontabiliteti apo interpretim, dhe në mënyrë specifike në ndonjë nga politikat kontabël të Shoqërisë.

3. Gjykime të rëndësishme kontabël, çmuarjet dhe vlerësimet

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon gjykime dhe vlerësime që ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe në raportimin e vlerave të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe të shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara nga shoqëria.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe janë bazuar në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë, përfshirë edhe pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme, të cilët besohet se janë të përshtatshëm dhe relevant për rrethanat aktuale. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën gjatë së cilës vlerësimi është rishikuar nëse rishikimi ndikon vetëm atë periudhë kontabël ose në periudhën gjatë së cilës vlerësimi është rishikuar dhe periudha të ardhshme nëse rishikimi ndikon të dyja periudhat si aktuale dhe të ardhshme.

Informacioni mbi elementët të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykimet mbi aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare janë të paraqitura më poshtë:

Percaktimi i vlerës së drejtë

Shoqëria nuk ka politika të rëndësishme kontabël dhe dhënie informacionesh shpjeguese të miratuara nga vet Shoqëria, të cilat kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, si për aktivitetet dhe detyrimet financiare dhe jofinanciare. Vlerat e drejta janë përcaktuar për qëllime të matjes dhe prezantimit. Aty ku është e aplikueshme, informacionet e mëtejshme në lidhje me supozimet e bëra në përcaktimin e vlerave të drejta janë shpalosur në shënimet specifike për atë aktivitet ose detyrimet.

Drejtimi i Shoqërisë vlerëson që vlera e drejtë e parasë dhe e parasë së ngurtësuar, llogarive të arkëtueshme, llogarive të pagueshme, aktiveve të tjera afatshkurtra dhe detyrimeve të tjera afatshkurtra dhe detyrimit për tatim fitimin, përafrohet me vlerën kontabile kryesisht për shkak të maturitetit afatshkurtër të këtyre instrumentave

ManeTCI Sh.p.k.

Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
(të gjitha shumat janë të shprehura në mije Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

3. Gjykime të rëndësishme kontabël, çmuarjet dhe vlerësimet (vazhdim)

Tatimi mbi fitimin

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Është i nevojshëm gjykimi për përcaktimin e shumës së tatimit mbi fitimin aktual dhe atyre të shtyra. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar tatimor është i pasigurt. Shoqëria një detyrimin në rast të auditimit të pritur tatimor bazuar në vlerësimet se taksa shtesë do mund të lindin si detyrim. Nëse tatimi përfundimtar do jete i ndryshëm nga shumat që ishin regjistruar fillimisht, diferencat do e ndikojë në vlerën aktuale të aktiveve tatimore të shtyra dhe pasiveve në periudhën në të cilën një përcaktim i tillë është bërë.

Rishikimi i zhvlerësimit

Rikuperimi i aktiveve është një çështje që kërkon gjykim të Drejtimit, që kërkon vlerësim nëse vlera kontabël e aktiveve mund të mbështetet në vlerën neto aktuale të flukseve monetare të ardhshme që pritet të gjenerohen nga përdorimi i aktiveve të tilla duke përdorur parashikimet e flukseve monetare të cilat janë skontuar me një normë të përshtatshme. Në llogaritjen e vlerës aktuale neto të flukseve monetare të ardhshme, janë të nevojshme supozime në lidhje me çështjet e pasigurta, siç përmendet më poshtë.

Standardet SNRF kërkojnë që Drejtimi të kryejë teste vjetore për zhvlerësimin e aktiveve dhe përcaktimin e jetës së tyre, gjithashtu kërkohet dhe vlerësimi i situatave të mundshme që do të sillnin mosrikuperimin e vlerës aktiveve. Bazuar në informacionin e disponueshëm dhe testimet, Shoqëria ka arritur në përfundimin se ka indikacione për zhvlerësim të aktiveve në 31 dhjetor 2017 të paraqitura në Shënimin 9 dhe Shënimin 12.

4. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

Politikat kontabël të përshkruara më poshtë janë zbatuar në mënyrë konsistente përgjatë gjithë periudhave të paraqitura në pasqyrat financiare dhe janë zbatuar në mënyrë konsistente nga shoqëria.

(a) Transaksionet në monedhë të huaj

Regjistrimet kontabël të shoqërisë janë paraqitur në monedhën vendase "Lek", e cila është monedha kryesore e mjedisit ekonomik në të cilën operon shoqëria.

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, transaksionet në monedhë tjetër nga monedha funksionale (monedha të huaja) regjistrohen me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Në fund të çdo periudhe raportuese, mjetet monetare në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin e datës së raportimit. Mjetet jo monetare që mbahen me vlerë të drejtë regjistrohen në monedhë të huaj dhe rivlerësohen në kursin e datës kur përcaktohet vlera e drejtë. Mjetet jo monetare që maten me kosto historike në monedhë të huaj nuk rivlerësohen.

Diferencat nga këmbimi njihen si fitim apo humbje në pasqyrën përmbledhëse e të ardhurave në periudhën në të cilën ndodhin, duke përjashtuar diferencat nga këmbimi në huamarrjen në monedhë të huaj të lidhura me aktivet në ndërtim, për përdorim frytëdhënës në të ardhmen, të cilat janë përfshirë në kostot e aktiveve si një rregullim të koston së interesit në huamarrjen në monedhë të huaj.

Transaksionet e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përkthyer me kursin e këmbimit të datës që ndodh transaksioni.

(a) Transaksionet në monedhë të huaj

	Kursi mesatar		Kursi në datën e raportimit	
	2017	2016	2017	2016
Lek / EUR	134.13	137.37	132.95	135.23
Lek / USD	119.05	124.14	111.10	128.17

(b) Instrumentat financiarë

Shoqëria fillimisht i ka njohur llogaritje të arkëtueshme dhe depozitat në datën e krijimit të tyre. Të gjitha të drejtat e tjera financiare (duke përfshirë edhe aktivet e vlerësuar me vlerën e drejtë) njihen në datën e tregtimit, datën kur Shoqëria ka lidhur një kontratë për këto instrumenta.

Shoqëria ç' regjistron një aktiv në momentin kur të drejtat kontraktuale për flukset e të ardhurave skadojnë, ose kur të gjitha të drejtat për të përfituar flukset kontraktuale të të ardhurave transferohen me anë të një transaksioni, i cili transferon përfitimet dhe risqet që lidhen me pronësinë e aktivit. Ndonjë interes që është mbajtur apo krijuar mbi aktivet e transferuara, paraqitet më vete si një e drejtë apo detyrim.

4. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(b) Instrumentat financiarë (vazhdim)

Një detyrim financiar c'regjistrohet kur detyrimi shlyhet, mbyllet ose përfundon afati i tij. Kur një detyrim financiar ekzistues zëvendësohet me kushte të ndryshme nga një tjetër po nga i njëjti kontraktor ose kushtet e detyrimit ekzistues modifikohen ndjeshëm, atëherë ai do të trajtohet si c'regjistrim i detyrimit aktual dhe njohjes së një detyrimi të ri. Diferenca nga kryerja e transaksionit do të njihen në pasqyrën e të ardhurave.

Detyrimet dhe të drejtat financiare netohen dhe paraqiten me vlerën neto në bilanc, vetëm kur Shoqëria ka të drejtën ligjore për të netuar vlerat dhe ka për qëllim të shlyejë këto neto, apo të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht. Instrumentat jo derivativë të Shoqërisë përfshijnë të tregëtueshmet dhe llogaritë e arkëtueshme, paraja dhe ekuivalentët e saj, të tregëtueshmet dhe llogaritë e pagueshme të tjera.

Paraja dhe ekuivalentë të saj

Paraja dhe ekuivalentë të saj përfshin para në arkë dhe llogaritë rrjedhëse bankare. Për qëllime të përgatitjes së pasqyrës së flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentë të saj përfshijnë para dhe depozita afatshkurtra të përcaktuara si neto nga overdrafti i pashlyer në bankë me maturitet deri në 3 muaj.

Bono privatizimi

Bonot e privatizimit janë instrumenta financiare të tregëtueshme midis individëve vendas dhe të huaj si dhe janë të vlefshme edhe në procesin e privatizimit të objekteve shtetërore ose ato mund të përdoren edhe në legalizimin e objekteve të ndërtuara pa leje. të cilat Shoqëria ka afat për ti përdorur deri me 31 dhjetor 2018 në rastet e specifikuar sipas legjislacionit lokal. Bonot e privatizimit janë rregjistruar me vlerën e blerjes.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme fillimisht shprehen me vlerë të drejtë dhe në vazhdimësi maten me kosto të amortizuar minus humbjet nga zhvlerësimi.

Huatë nga Institucionet financiare

Huatë e marra nga institucionet financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë, duke zbritur koston e transaksionit. Detyrimet financiare maten më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, duke njohur shpenzimin e interesit mbi bazën e interesit efektiv.

Metoda e normës efektive të interesit është një metodë llogaritje për koston e amortizuar të një detyrimi financiar dhe e alokimit të shpenzimit të interesit përgjatë periudhës. Norma efektive e interesit është norma e cila skanton ekzaktesisht pagesat e ardhshme të vlerësuara përgjatë jetës së pritshme të detyrimit financiar, ose, ku është e përshtatshme, për një periudhë më të shkurtër.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme fillimisht shprehen me vlerë të drejtë dhe në vazhdimësi maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.

Të tjera

Instrumenta të tjerë financiarë jo-derivativ vlerësohen me koston e amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv minus humbjet nga zhvlerësimi.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar i shoqërisë njihet me vlerë nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapital.

(b) Aktive afatgjata te investimit

Aktivet afatgjata te investimit, të cilat janë prona të mbajtura për të fituar të ardhura nga qerata dhe/ose për rivlerësimin e kapitalit (duke përfshirë edhe prona për ndërtim për qëllime të tilla), vlerësohen fillimisht me kosto duke përfshirë edhe kostot e transaksionit. Ato fillimisht njihen në pasqyrën e pozicionit financiar në momentin që rreziqet dhe përfitimet nga pronësia transferohen të shoqëria pavaresisht nga fakti nëse titulli është transferuar ose jo.

Pas njohjes fillestare, aktivet afatgjata te investimit maten me vlerën e drejtë, e cila reflekton kushtet e tregut në datën e raportimit. Fitimet ose humbjet që rrjedhin nga ndryshimet në vlerat e drejta të pronave të investimit janë përfshirë në fitim ose humbje në periudhën në të cilën ato paraqiten, duke përfshirë efektin përkatës tatimor.

Transferimet bëhen (ose nga) aktivet afatgjata te investimit vetëm kur ka një ndryshim në përdorim. Për një transferim nga aktivet afatgjata te investimit në inventar, kostoja e supozuar për kontabilitetin pasues është vlera e drejtë në datën e ndryshimit në përdorim.

4. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(c) Aktive afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Aktivitet afatgjata materiale, maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi.

Kostot përfshijnë shpenzimet që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të ndërtuara nga vetë shoqëria përfshin koston e materialeve dhe punës direkte që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me sjelljen e aktivitet në gjendje pune për qëllimin e caktuar, kostot e çmontimit dhe lëvizjen e aktiveve të ndryshme dhe kthimin e vendodhjes së tyre në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot e kapitalizuara të huave. Kostot gjithashtu mund të përfshijnë zëra të transferuar nga të ardhurat përmbledhëse të tjera në lidhje fitime apo humbje të flukseve të parasë të kualifikuara nga mbulimi për blerjen e pronave dhe paisjeve. Blerja e programeve kompjuterike të cilat janë pjesë përbërëse të funksionalitetit të paisjeve përkatëse kapitalizohet si pjesë e asaj paisjeje.

Në momentin që një nga aktivitet afatgjata materiale përbëhet nga pjesë me jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato regjistrohen si pjesë të ndara nga njëra tjetra. Fitimet ose humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve materiale përcaktohen duke krahasuar arkitimet nga shitja me vlerën kontabël neto të aktivitet dhe njihet neto në të ardhura ose humbje të tjera.

Kostot në vijim

Kostot për zëvendësimin e një aktivitet regjistrohen me vlerën kontabël të aktivitet në rast së është e mundur që përfitimet ekonomike në periudhat e ardhshme të përfshira në të, të mund të rrjedhin tek shoqëria dhe kostoja të mund të matet me besueshmëri. Vlera kontabël e pjesëve të ndërruara si rrjedhojë ç' regjistrohet. Kostoja e shërbimit ditor, të vazhdueshëm të ndërtesave dhe paisjeve regjistrohet tek fitimet ose humbjet kur ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi llogaritet mbi vlerën e amortizueshme e cila është kostoja e aktivitet ose cdo kosto tjetër zëvendësuese minus vlerën e mbetur. Amortizimi njihet në pasqyrën përmbledhëse e të ardhurave bazuar në metodën e vlerës së mbetur sipas normave të mëposhtme për secilin kategori asetesh:

- | | |
|-----------------------|-----|
| a) Ndertesa | 5% |
| b) Makineri paisje | 20% |
| c) Mjete transporti | 20% |
| d) Paisje informatike | 25% |
| e) Paisje zyre | 20% |

Kjo mënyrë pasqyron më përafërsisht trendin e konsumit të përfitimeve të ardhshme ekonomike të përfshira në këto aktive. Tokat dhe Aktivitet në proces nuk amortizohen. Normat e amortizimit dhe vlerat e mbetura, nëse janë të rëndësishme, aktivitet afatgjata materiale rievlerësohen në datën e raportimit.

(c) Zhvlerësimet e aktiveve

Aktivitet financiare

Një aktiv financiar që nuk mbahet me vlerën e drejtë, vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna objektive që ka pësuar rënie në vlerë. Një aktiv financiar bie në vlerë nëse ka të dhëna objektive të një ngjarje që ka çuar në zhvlerësimin e tij pas momentit fillestar të njohjes së aktivitet, dhe kjo ngjarje ka efekt negativ në flukset e vlerësuar në të ardhmen nga aktivitet të cilat mund të maten me besueshmëri.

Humbja nga rënia në vlerë e aktivitet të vlerësuar me koston e amortizuar llogaritet si diferencë midis vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme që priten të gjenerohen nga ky aktiv financiar i skontuar me normën fillestare efektive të interesit. Humbjet njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave (në humbje ose fitim). Interesi nga aktivitet e zhvlerësuar në këtë mënyrë vazhdon të njihet nëpërmjet amortizimit të skontos. Kur një ngjarje pasuese shkakton zvogëlimin e rënies në vlerë, shuma përkatëse rimerret nëpërmjet pasqyrës përmbledhëse të të ardhurave.

Aktivitet jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo financiare të shoqërisë rishikohet në datën e raportimit për të përcaktuar nëse ka ndonjë të dhënë për rënie në vlerë. Nëse ekziston ndonjë evidencë e tillë për rënie në vlerë atëherë matet vlera e rikuperueshme e aktivitet. Vlera e rikuperueshme është vlera më e madhe midis vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Gjatë vlerësimit të vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të vlerësuar skontoohen për të arritur në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit, e cila reflekton

4. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(c) Zhvlerësimet e aktiveve (vazhdim)

Aktivet jo-financiare (vazhdim)

vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqeve specifike të aktiveve që nuk janë marrë parasysh në vlerësimin e flukseve të ardhshme.

Një humbje nga rënia e vlerës njihet nëse vlera kontabël e aktivitetit tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën përmbledhëse e të ardhurave.

(d) Marrëveshjet e përbashkëta

Marrëveshjet e përbashkëta janë inkorporuar veçmas. Shoqëria, pasi ka marrë parasysh strukturën dhe formën të marrëveshjes, kushtet e dakorduara nga palët në marrëveshjen kontraktuale dhe të drejtat e Shoqërisë dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëveshja, ka klasifikuar interesat e saj si aktivitet financiar sipas SNK 39.

(e) Inventar prona

Prona e blere ose që po ndërtohet për shitje në rrjedhën normale të biznesit, në vend që të mbahet për tu dhene me qera ose fitimit nga rritja e vlerës, mbahet si inventar dhe matet me vlerën me të vogël nga kosto historike dhe vlera neto e realizueshme (NRV).

Kostoja përfshin:

- Të drejtat mbi pasurinë e lirë dhe qiranë mbi tokën
- Shumat e paguara për kontraktuesit për ndërtim
- Kostot e huamarrjes, kostot e planifikimit dhe të projektimit, kostot e infrastruktures, tarifave profesionale për shërbimet ligjore, taksat e transferimit të pronës, shpenzimet e ndërtimit dhe shpenzimet e tjera të ngjashme

Komisionet e paktyeshme që u paguhen shitësve ose agjentëve të marketingut për shitjen e njësisve të pasurive të paluajtshme shpenzohen kur paguhen.

NRV është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën normale të biznesit, bazuar në çmimet e tregut në datën e raportimit minus kostot e vlerësuara të përfundimit dhe kostot e vlerësuara të nevojshme për të bërë shitjen, duke marrë parasysh vlerën e parase në kohë nëse është materiale.

Kostoja e pronës së inventarit e njohur në fitim ose humbje përcaktohet duke iu referuar shpenzimet specifike të shkaktuara në pronën e shitur dhe alokimin e çdo kostose jo specifike bazuar në madhësinë e pronës së shitur.

(f) Përfitimet e punonjësve

Kontributet e sigurimeve shoqërore

Gjatë ecurisë normale të biznesit, shoqëria bën pagesa në emër të saj dhe të punonjësve për kontributet shoqërore, të cilat janë të detyrueshme bazuar në legjislacionin vendas. Këto kosto të kryera në emër të shoqërisë, janë të paraqitura në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në momentin e ndodhjes.

Pensionet e detyrueshem

Shoqëria, gjatë aktivitetit të saj, bën pagesa në emër të saj dhe në emër të punonjësve për të kontrivuar në planin e pensionit sipas legjislacionit lokal. Kostot që ndodhin për këto plane i takojnë Shoqërisë dhe ngarkohen në fitimin ose humbjen brenda vitit ushtrimor.

Leja e zakonshme e paguar

Shoqëria njihet si detyrim shumat e paskontuara të kostove të lidhura me lejen vjetore e cila pritet të paguhet në shkëmbim të shërbimit të ofruar nga punonjësi për periudhën.

(f) Provigjonet

Një provigjon njihet kur, si pasojë e ngjarjeve të kaluara, shoqëria ka detyrime aktuale ligjore apo konstruktive të cilat mund të vlerësohen me vërtetësi, dhe ka mundësi që të ketë nxjerrje të flukseve të ardhshme të parasë për të shlyer këtë detyrim. Provigjonet përcaktohen si aktualizimi i flukseve të pritshme me një normë takse që reflekton vlerësimet aktuale të tregut të parasë dhe rrezikut specifik të detyrimeve.

4. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(g) Njohja e të ardhurave

Të ardhurat njihen në masën që është e mundur që përfitimet ekonomike do të gjenerohen dhe mund të maten në mënyrë të besueshme, pavarësisht se kur është marrë pagesa. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh kushtet e përcaktuara në kontratën e pagesës dhe duke përjashtuar taksat ose detyrimet. Shoqëria ka konstatuar se është kryesori në të gjitha të ardhurat e saj sepse është përgjegjësi për përmbushjen e detyrimeve, ka kontroll mbi çmimin dhe gjithashtu ekspozohet ndaj rreziqeve të inventarit dhe kredisë.

Kriteret specifike të njohjes të përshkruara më poshtë duhet të plotësohen para se të njihen të ardhurat.

i. Shitja e pronës së përfunduar

Një pasuri konsiderohet si e shitur kur rreziqet dhe përfitimet e rëndësishme të pronësisë transferohen tek blerësi, i cili normalisht është në transferimin ligjor të titullit të pronësise në rastet e kontratave të shkëmbimeve të pakushtëzuara. Për kontratat me shkëmbime të kushtëzuara, shitja njihet vetëm kur plotësohen të gjitha kushtet e rëndësishme.

ii. Shitjet e pronës në zhvillim

Aty ku prona është në zhvillim e sipër dhe është arritur marrëveshje për të shitur një pronë të tillë kur ndërtimi është i plotë, Shoqëria shqyrton nëse kontrata përfshin:

- një kontratë për ndërtimin e një prone, OSE
- një kontratë për shitjen e një prone të përfunduar

Kur një kontratë përcaktohet të jetë për ndërtimin e një prone, të ardhurat njihen duke përdorur metodën e përqindjes së përfundimit sipas progresit të ndërtimit.

Kur kontrata përcaktohet të jetë për shitjen e një prone të përfunduar, të ardhurat njihen kur rreziqet dhe përfitimet e rëndësishme të pronësisë së pasurisë së patundshme janë transferuar tek blerësi. Nëse, kushtet ligjore të kontratës janë të tilla që ndërtimi përfaqëson transferimin e vazhdueshëm të punës tek blerësi, aplikohet metoda e përqindjes së përfundimit të njohjes së të ardhurave dhe të ardhurat njihet sipas progresit të punës. Transferimi i vazhdueshëm i punës në proces është aplikuar kur:

- Blerësi kontrollon punën në vazhdim, zakonisht kur toka në të cilën zhvillohet ndërtimi është në pronësi të konsumatorit final, dhe
- Të gjitha rreziqet dhe përfitimet e rëndësishme të pronësisë së punës në vazhdim në gjendjen e tanishme janë transferuar te blerësi sipas progresit të ndërtimit, zakonisht, kur blerësi nuk mund ta kthejë pronën e paplotë të Shoqëria.

Në situata të tilla, përqindja e punës së kryer matet në bazë të shpenzimeve të kryera deri në fund të periudhës së raportimit si një proporcion i kostove totale që priten të ndodhin.

iii. Të ardhurat nga qeraja

Të ardhurat nga qeraja janë të drejta që i linden shoqërisë nga qeratë operative, duke përjashtuar të ardhurat nga qera të kushtëzuara, të cilat njihen kur ato plotësohen. Kostot fillestare direkte që ndodhin në momentin e negociimit të një kontrate qeraje operative, njihen si shpenzim gjatë kohëzgjatjes së qerasë, në të njëjtën mënyrë si të ardhurat nga qeraja.

Kushtet lehtësuese të një marrëveshje qeraje janë të përcaktuara në termat e qerasë, dhe shpërndahen gjatë afatit të qerasë, edhe nëse pagesat nuk janë kryer mbi këtë bazë. Termat e qerasë janë të pa kthyeshme gjatë kohëzgjatjes së qerasë së bashku me cdo term tjetër, deri në momentin ku qeramarrësi ka opsionin për të vazhduar qeranë, dhe drejtuesit kanë siguri që qeramarrësi do ta ushtrojë këtë opsion.

Shuma e përfituar nga qeramarrësi për të përfunduar marrëveshjen e qerasë njihen në pasqyrën e të ardhurave kur lind e drejta e përfitimit të tyre.

iv. Pagesat e shërbimit, pagesat e menaxhimit dhe shpenzimet e tjera të rikuperueshme nga qiramarrësit

Të ardhurat që rrjedhin nga shpenzimet e rialokuara për qiramarrësit njihen në periudhën në të cilën kompensimi bëhet i arkëtueshëm. Tarifat e shërbimit dhe të menaxhimit dhe faturat e tjera të tilla përfshihen në të ardhurat neto nga qiraja bruto nga kostot përkatëse.

4. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(g) Njohja e të ardhurave (vazhdim)

v. Të ardhurat nga interesi

Të ardhurat nga interesi njihen sic ato realizohen duke përdorur metodën e interesit efektiv (EIR). Interesi efektiv është norma që saktësisht zbrret flukset e ardhshme të vlerësuara gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar ose një periudhë më të shkurtër, kur është e përshtatshme, në vlerën kontabël neto të aktivit financiar. Të ardhurat nga interesi janë të përfshira në të ardhurat financiare në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

(h) Pagesat e qirasë

Qeratë klasifikohen si qira financiare kur kushtet e qirasë transferojnë në mënyrë domethënëse të gjitha risqet dhe përfitimet e pronësisë tek qiramarrësi. Të gjitha qiratë e tjera klasifikohen si qira operative. Pagesat e bëra për qiranë operative janë paraqitur në pasqyrën e të ardhurave në bazë lineare përgjatë kohëzgjatjes së kontratës. Shoqëria ka hyrë në marrëveshje qiraje për prona tregtare, dhe ka përcaktuar, bazuar në vlerësimet kushtet e marrëveshjes, ku zotëron të gjitha risqet dhe përfitimet mbi këto prona dhe për këtë arsye i konsideron ato si qira operative.

Shoqëria si qiramarrëse

Qeratë financiare që transferojnë rrezikun dhe përfitimet në mënyrë aksidentale tek shoqëria, janë kapitalizuar si një fillim i ri i qirasë me vlerën e drejtë të pronës së dhënë më qira, ose nëqoftëse është më e vogël me vlerën aktuale të minimumit të pagesave të qirasë. Pagesat e qirasë janë të ndarë midis pagesave financiare dhe uljes së detyrimit ndaj qirasë, për të arritur në një nivel konstant të interesit në tepricën e mbetur të detyrimit. Pagesat financiare janë njohur si kosto financiare në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Një aktiv i dhënë me qira është amortizuar gjatë jetës së dobishme të tij. Megjithatë, meqënëse shoqëria nuk ka një siguri që do të zotërojë pronësinë në fund të kohëzgjatjes së qirasë, aktivi do të amortizohet për një periudhë më të vogël se jeta e dobishme e tij. Pagesat e qirasë operative janë njohur si shpenzime operative në pasqyrën e të ardhurave në mënyrë lineare gjatë kohëzgjatjes së qirasë.

Shoqëria si qiradhënëse.

Qeratë ku shoqëria nuk transferon konsiderueshëm risqet dhe përfitimet e pronësisë të një aktivi janë klasifikuar si qira operative. Kostot direkte fillestare të ndodhura për pershtatjen e ambienteve sipas kërkeses së qerramarresit të një qiraje operative i shtohen shumës së aktivitetit të dhënë me qira dhe njihen në të njëjtën bazë si të ardhura nga qiraja. Qeratë e ndara do të njihen si të ardhura në periudhën në të cilën ato janë përfituar, në mënyrë lineare gjatë kohëzgjatjes së qirasë.

Depozitimet e qiramarrësit

Detyrimet për depozitim të qiramarrësit njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe në vazhdim me koston e amortizuar kur ka vlerë materiale. Cdo diferencë midis vlerës së drejtë fillestare dhe vlerës nominale përfshihet si një e ardhur përbërëse e qirasë dhe njihen në mënyrë lineare përgjatë gjithë termave të qirasë.

(i) Të ardhurat dhe kostot financiare

Të ardhurat financiare përbëhen nga të ardhurat nga interesi për fondet e investuara në depozita bankare dhe nga të ardhurat nga këmbimi.

Kostot financiare përbëhen nga shpenzimet e interesit të huave, shpenzime nga kurset e këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare në fitim dhe humbje, dhe nga rënia në vlerë e aktiveve financiare. Humbjet apo fitimet nga kursi i këmbimit janë paraqitur në vlerë neto.

4. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(j) Kostot e huave

Kostot e huave të lidhura direkt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e aktiveve, të cilat duan një kohë të gjatë për tu sjellë në formë përfundimtare, në mënyrë që të përdoren apo shiten, i shtohen kostos së këtyre aktiveve, deri në momentin kur këto aktive janë gati që qëllimin e tyre për përdorim ose për shitje.

Të ardhurat nga investimet e përkohshme, për sa i përket disa huave të veçanta, të cilave ende nuk ju është paguar interesi, kjo shumë ju zbritet kostove të huamarrjes dhe nuk i kapitalizohet kostos së aktivit.

Të gjitha kostot e tjera njihen si të ardhura ose shpenzime në periudhën kur ato kanë ndodhur.

(k) Shpenzime për tatim fitimin

Tatimi mbi fitimin nënkupton tatimin e periudhës dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në të ardhura ose shpenzime përveç rasteve kur lidhen me zëra të njohur direkt në kapital, në të cilat rregjistrohen direkt në kapital. Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm i pagueshëm mbi fitimin e tatueshëm për vitin, duke përdorur normat e tatimeve në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo sistemim mbi tatimin e pagueshëm të lidhur me vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet si diferenca e përkohshme mes vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve në pasqyrat financiare dhe bazës së tatueshme korresponduese përdorur në llogaritjen e fitimit të tatueshëm.

Detyrimet e tatimit të shtyrë në përgjithësi llogariten për të gjitha diferencat e tatueshme të përkohshme. Aktivitetet e tatimit të shtyrë në përgjithësi njihen për të gjitha diferencat e zbritshme të përkohshme në masën që ekziston mundësia që fitimi i tatueshëm do të jetë i mundshëm në mënyrë që këto diferenca të zbritshme të përkohshme të mund të përdoren. Këto aktive dhe detyrime të tatimit të shtyrë nuk do të njihen në qoftë se këto diferenca rezultojnë nga njohja fillestare e aktiveve dhe detyrimeve në një transaksion që nuk prek as fitimin e tatueshëm, as fitimin kontabël.

Vlera kontabël e aktiveve dhe detyrimeve të tatimit të shtyrë rishikohet në fund të çdo periudhe raportuese dhe reduktohet në masën që nuk është më e mundur që të arrihet një fitim i tatueshëm i mjaftueshëm që të lejojë që një pjesë ose i gjithë aktiviteti të rikuperohet. Detyrimet dhe aktivitetet e tatimit të shtyrë maten me normën e tatimit që pritet të përdoret në periudhën në të cilën detyrimi ka ndodhur ose aktiviteti është realizuar, bazuar në normat e tatimit dhe legjislacionit fiskal që ka qenë në fuqi ose ka hyrë në fuqi në fund të periudhës së raportimit.

Tatim fitimi dhe tatimi i shtyrë i vitit

Tatim fitimi dhe tatimi i shtyrë i vitit njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse, përveçse kur lidhen me zëra që njihen në të ardhura të tjera gjithpërfshirëse ose drejtpërdrejtë në kapital, rast në të cilin tatim fitimi dhe tatimi i shtyrë njihen gjithashtu në të ardhura të tjera gjithpërfshirëse ose drejtpërdrejtë në pasqyrën e kapitalit përkatësisht.

ManeTCI Sh.p.k.

*Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
(të gjitha shumat janë të shprehura në mije Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)*

4. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**4.1 Korigjimi i gabimeve**

Gjatë vitit në shqyrtim, Shoqeria ka identifikuar se pasqyrat financiare të vitit të kaluar përmbanin gabime materiale në lidhje me njohjen, matjen, paraqitjen dhe dhënien e informacioneve shpjeguese të elementeve të përfshira në pasqyrat financiare. Si rezultat dhe në përputhje me SNK 8 - Politikat e Kontabilitetit, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet, këto gabime u korrigjuan duke rishikuar bilancin fillestar të kapitalit dhe krahasimet. Më konkretisht, shumat për periudhën raportuese paraprake në të cilën ndodhën gabimet janë riparaqitur.

Pasqyra e pozicionit financiar:

		31 dhjetor 2016		
		Perpara rideklarimit	Korigjimi gabimit	Rideklaruar
Aktive				
Aktive afatgjata materiale	A	227,107	(92,551)	134,556
Inventari	A,B	4,331,946	(147,270)	4,184,676
Total - Aktive		4,559,053	(239,821)	4,319,232
Detyrime				
Kredi me interes dhe huamarrje	C	948,550	(421,453)	527,098
Detyrime të tjera financiare	C	96,752	421,453	518,204
Tatim fitimi i pagueshem	F	85,247	(35,973)	49,273
Total - Detyrime		1,130,549	(35,973)	1,094,575
Efekti neto ne fitimin e vitit		998,723	(203,848)	794,875

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe te ardhurave gjithperfshirese:

		31 dhjetor 2016		
		Perpara rideklarimit	Korigjimi gabimit	Rideklaruar
Te ardhura nga shitja e punimeve dhe mirembajtja	D	1,049,154	(435,318)	613,836
Të ardhura të tjera	D	12,025	(32)	11,993
Kosto e inventarit prone te shitur	B	(1,849,514)	(244,691)	(2,094,205)
Blerje e materialeve dhe punimeve	D	(739,055)	386,705	(352,350)
Blerje e sherbimeve	D	(91,841)	24,452	(67,389)
Shpenzime administrative	D	(70,949)	741	(70,208)
Amortizimi	D	(34,076)	4,871	(29,205)
Shpenzime personeli	D	(114,259)	18,396	(95,864)
Shpenzime financiare	D	(26,526)	5,057	(21,469)
Efekti ne fitimin para tatimit		(1,865,041)	(239,819)	(2,104,861)
Tatimi mbi fitimin	F	(137,273)	35,973	(101,300)
Efekti neto ne fitimin e vitit		998,722	(203,847)	794,875

Baza e riparaqitjes së gabimeve të identifikuar është shpjeguar më poshtë.

A – Shoqeria gjate vitit 2016 ka rregjistruar si aktive afatgjata materiale prona te cilat jane lene me qera ne kundershtim me kushtet e njohjes sipas *SNK 16 – Aktive afatgjata materiale*. Sipas *SNK 40 – Aktive afatgjata te investimit* kur aktivet te cilat do te shiten gjate ushtrimin te aktivitetit te Shoqerise perdoren per te gjeneruar te ardhura ne formen e qerave per periudhen kohore deri ne gjetjen e blesesve, vazhdojne te klasifikohen ne inventar. Si pasoje Aktivet afatgjata materiale ishin mbivleresuar per fundin e vitit 2016 dhe shpenzimi amortizimit mbivleresuar si pasoje e llogaritjes se amortizimit.

4. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.1 Korigjimi i gabimeve (vazhdim)

B – Shoqëria për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2016 kishte mbivlerësuar inventarin si rrjedhojë të perlllogaritjes së pasakte të kostove të perbashketa të infrastruktures, specifikisht, tejkalimi i buxhetit fillestar nuk ishte shperndare në kosto për njësi. Rrjedhimisht kostoja e inventarit të shitur në vitin 2016 ishte nënvlerësuar.

C – Shoqëria për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2016 kishte klasifikuar detyrimet për palet e lidhura si huamarrje ndaj institucioneve financiare.

D – Shoqëria gjatë vitit 2016 ka rregjistruar si të ardhura dhe shpenzime autofaturimet në lidhje me projektet, ku vepron si sipërmarrës si dhe ndertues, për të permbushur kërkesat ligjore lokale. Sipas *SNK 18 – Te ardhurat*, këto rregjistrime nuk permbushin kushtet e njohjes si të ardhura.

F – Shpenzimi i tatimit fitimit ka ndryshuar si pasojë e rideklarimit të kostos së shitjes (pika B) dhe c' rregjistrimit të llogaritjes së amortizimit (pika A).

5. Standarde të reja dhe amendimet

5.1 Standarde dhe interpretime të publikuara që nuk janë ende të aplikueshme

Standardet dhe interpretimet që janë lëshuar, por ende nuk janë efektive, deri në datën e lëshimit të pasqyrave financiare të Shoqërisë janë dhënë më poshtë. Shoqëria synon të miratojë këto standarde, nëse është e aplikueshme, kur ato të hyjnë në fuqi.

SNRF 9 Instrumentet Financiare

Në korrik 2014, Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK), publikoi versionin final të SNRF 9 Instrumentat Financiare, i cili zëvendësoi SNK 39 Instrumentat Financiare. Njohja dhe Matja si dhe të gjitha versionet e mëparshme të SNRF 9. SNRF 9 përmbledh të treja aspektet e projektit të kontabilizimit të instrumentave financiarë: klasifikimi dhe matja, zhvlerësimi dhe kontabilizimi mbrojtës. SNRF 9 është efektiv për periudhat që fillojnë në ose pas 1 janar 2018, ku aplikimi i më hershëm është i lejuar. Me përjashtim të kontabilitetit mbrojtës, aplikimi në periudhat e mëparshme është i kërkuar, por informacioni krahasues nuk është i detyrueshëm. Për kontabilitetin mbrojtës, kërkesat përgjithësisht kërkojnë aplikim në periudhat në vijim, më një numër të përcaktuar përjashtimesh.

Shoqëria planifikon të aplikojë standartin e ri në datën efektive të përcaktuar dhe nuk do të rideklorojë informacionin krahasues. Gjatë vitit 2017, Shoqëria do të kryej një vlerësim të ndikimit të tre aspekteve të SNRF 9. Ky vlerësim do të bazohet në informacionin aktual dhe mund të jetë subjekt i ndryshimeve që vijnë nga informacioni i mëtejshëm i asyretueshëm që do të jetë në dispozicion të Shoqërisë në vitin 2018 kur

Shoqëria të aplikojë SNRF 9. Në përgjithësi, Shoqëria nuk pret ndonjë ndikim domethënës në pasqyrën e pozicionit financiar dhe në kapital.

Shoqëria nuk pret ndonjë ndryshim në humbjet nga zhvlerësimi. Për më tepër, Shoqëria, për shkak të llojeve të limituara të instrumentave financiarë, nuk pret ndryshime në klasifikimin e instrumentave financiarë (p.sh. llogari të arkëtueshme dhe kredi të dhëna).

(a) Klasifikimi dhe matja

Shoqëria nuk pret ndonjëndikim të rëndësishëm në bilanin apo kapitalin e saj nga aplikimi i klasifikimit dhe matjes së kërkuar nga SNRF 9. Ajo pret të vazhdojë matjen me kosto të amortizuar të të gjitha aktiveve financiare aktualë të prezantuara nën zërin “aktivet afatshkurtra”.

Llogaritë e arkëtueshme mbahen për të mbledhur flukse hyrëse kontraktuale dhe pritet që të sjellin flukse të parasë që përfaqësojnë vetëm pagesa kontraktuale dhe interesa. Bazuar në marrëveshjet kontraktuale me klientët e saj, Shoqëria ka analizuar karakteristikat e flukseve kontraktuale të këtyre instrumentave dhe ka arritur në përfundimin që ato plotësojnë kushtet për matjen me kosto të amortizuar sipas SNRF 9. Kështu që, nuk kërkohet riklasifikimi i këtyre instrumentave.

Shoqëria nuk ka instrumenta financiare të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse (VDNAP/FVOCI) ose të vlerës së drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDNFH/FVTPL). Gjithashtu, nuk ka instrumenta të kapitalit apo derivativë në datën e këtyre pasqyrave financiare.

(b) Zhvlerësimi

SNRF 9 kërkon që Shoqëria të regjistrojë humbjet e pritshme të kredisë të të gjitha letrave me vlerë, kredive dhe llogarive të arkëtueshme, në baza 12 mujore ose të jetëgjatësisë. Shoqëria do të aplikojë metodën e thjeshtuar dhe do të regjistrojë humbjet e pritshme të jetëgjatësisë të të gjitha llogarive të arkëtueshme. Shoqëria ka përcaktuar se, për shkak të praktikave aktuale të termave të pagesës, e rregulluar nëpërmjet kontratave

5. Standarde të reja dhe amendimet (vazhdim)

5.1 Standarde dhe interpretime të publikuara që nuk janë ende të aplikueshme (vazhdim)

SNRF 9 Instrumentet Financiare (vazhdim)

(b) Zhvlerësimi (vazhdim)

individuale me shoqëritë, kërkon parapagime dhe/ose garanci nga kompanitë e reja dhe nuk pret që këto ndryshime të kenë një ndikim të rëndësishëm.

SNRF 15 Të Ardhurat nga Kontratat me Konsumatorët

SNRF 15 është publikuar në maj 2014, dhe i përmirësuar në prill 2016, dhe përdorur një model me pesë hapa për kontabilizimin e të ardhurave që rezultojnë nga kontratat me konsumatorët:

- identifikimi i kontratës me një klient
- identifikimi i detyrimeve të performancës në kontratë
- përcaktimi i çmimit të transaksionit
- shpërndarja e çmimit të transaksionit ndaj detyrimeve të performancës në kontratë, dhe
- Njohja e të ardhurave kur (ose si) njësia ekonomike përmbush një detyrim të performancës.

Sipas SNRF 15, parimi bazë është që një njësi ekonomike do të njohë të ardhurat në një shumë që reflekton shumën në të cilën njësia ekonomike pret të ketë të drejtë në këmbim të transferimit të mallrave ose shërbimeve për një klient.

Ndryshimet kryesore nga praktika aktuale:

- Cdo mall apo shërbim i premtuar, i cili është i dallueshëm, duhet të njihet më vete, dhe cdo zbritje mbi çmimin e kontratës, në përgjithësi duhet të shpërndahet mbi elementet e vecantë.
- E ardhura mund të njihet më heret sesa sipas standarteve aktuale nëse vlerësimi ndryshon për ndonjë arsye (sic mund të jenë incentivat, ulje të tjera, tarifat e performancës, honoraret, suksesi i një rezultati etj) – shumata minimale duhet të njihet nëse ato nuk përbëjnë një risk të rëndësishëm kthimi.
- Momenti në të cilin e ardhura është e mundur të njihet mund të zhvendoset: disa të ardhura të cilat aktualisht janë njohur në momentin e përfundimit të kontratës, mund të duhen të njihen gjatë kohëzgjatjes së kontratës ose e kundërta.
- Ka rregulla specifike mbi licencat, garancitë, tarifave fillestare të parimbursueshme dhe marrëveshjet e ndërmjetësimit, sa për të përmendur disa.

Si për cdo standart të ri, ka nivel të zgjeruar të shënimeve shpjeguese.

Standarti i ri i të ardhurave do të zëvendësojë të gjitha kërkesat aktuale të njohjes së të ardhurave sipas SNRF. Aplikimi është efektiv për periudhat më ose pas 1 janar 2018 dhe metodat e aplikimit janë ose aplikim i plotë i periudhave të mëparshme ose aplikim i modifikuar i periudhave të mëparshme. Aplikimi i më hershëm është i lejuar. Shoqëria planifikon të aplikojë standartin e ri në datën e kërkuar efektive duke përdorur metodën e modifikuar të periudhave të mëparshme, që do të thotë se efekti i akumuluar i aplikimit do të njihet në fitimet e mbartura më 1 janar 2018 dhe që pasqyrat krahasuese nuk do të ndryshohen. Për rrjedhojë, Shoqëria do të aplikojë SNRF 15 në mënyre prapavepruese vetëm për kontratat që nuk janë përfunduar në datën e aplikimit fillestar (pra 1 janar 2018). Gjate vitit 2018 Shoqëria do të bëjë një vlerësim të efektit të mundshëm të SNRF 15 në pasqyrat e saj financiare.

SNRF 16 Qiratë

SNRF 16 është lëshuar në janar 2016 dhe zëvendëson SNK 17 Qiradhënie, KIRFN 4 Përcaktimi nëse një Marrëveshje përmban një qira, SIC-15 Nxitjet e Qirasë Operative dhe KIS-27 Vlerësimi i Substancës së Transaksioneve që përfshijnë Formën Ligjore të Qirasë. SNRF 16 përcakton parimet për njohjen, matjen, paraqitjen dhe dhënien e informacioneve shpjeguese të qirasë dhe kërkon që qiramarrësit të japin llogari për të gjitha qiratë sipas një modeli të vetëm në bilanc, ngjashëm me kontabilitetin për qiratë financiare sipas SNK 17. Kontabiliteti i qiradhënësive sipas SNRF 16 është në thelb i pandryshuar nga kontabilizimi i sotëm sipas SNK 17. SNRF 16 gjithashtu kërkon që qiramarrësi dhe qiradhënësi të bëjnë më shumë informacion shpjegues se sa sipas SNK 17. SNRF 16 është efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019. Aplikimi i hershëm lejohet, por jo para se një entitet të zbatojë SNRF 15. Një qiramarrës mund të zgjedhë të zbatojë standardin duke përdorur një qasje të plotë retrospektive ose një modifikim retrospektiv. Dispozitat e tranzicionit të standardit lejojnë lehtësime të caktuara. Shoqëria nuk pret që aplikimi i këtij standarti të ri të ketë ndikim në pasqyrat e saj financiare, duke qenë se ajo nuk ka transaksione materiale si qeramarrëse.

5. Standarde të reja dhe amendimet (vazhdim)

5.1 Standarde dhe interpretime të publikuara që nuk janë ende të aplikueshme (vazhdim)

Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28: Shitja ose Kontributi i Aktiveve midis një Investitori dhe Shoqatës së saj ose Sipërmarrjes së Përbashkët

Ndryshimet adresojnë konfliktin midis SNRF 10 dhe SNK 28 në trajtimin e humbjes së kontrollit të një filiali që shitet ose kontribuohet në një Shoqatë ose Sipërmarrje të përbashkët. Ndryshimet sqarojnë se fitimi ose humbja që rezultojnë nga shitja ose kontributi i aktiveve që përbëjnë një biznes, siç përcaktohet në SNRF 3, midis një investitori dhe shoqatës së tij ose sipërmarrjes së përbashkët, njihet plotësisht. Çdo fitim ose humbje që rezultojnë nga shitja ose kontributi i aktiveve që nuk përbëjnë një biznes, megjithatë, njihet vetëm në masën e interesave të investitorëve të palidhur në shoqatës aksionare ose sipërmarrje të përbashkët. IASB ka shtyrë datën efektive të këtyre ndryshimeve për një kohë të pacaktuar, por një entitet që në fillim i miraton ndryshimet, duhet t'i zbatojë ato në mënyrë prospektive.

SNRF 17 Kontratat e Sigurimeve

Në Maj 2017, BSNK publikoi SNRF 17 Kontratat e Sigurimeve (SNRF 17), një standard i ri kontabël i përgjithshëm për kontratat e sigurimeve. Sapo të hyjë në fuqi, SNRF 17 do të zëvendësojë SNRF 4 Kontratat e Sigurimeve (SNRF 4). SNRF 17 zbatohet për të gjitha llojet e kontratave të sigurimit (dmth jetë, jo-jetë, sigurimi i drejtpërdrejtë dhe risigurimi) pavarësisht llojit të subjekteve që i lëshojnë ato, si dhe garancive të caktuara dhe instrumenteve financiare me karakteristika të pjesëmarrjes së lirë. SNRF 17 është efektive për periudhat e raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021, me shifra krahasuese të nevojshme. Aplikimi i hershëm është i lejuar, me kusht që entiteti të zbatojë gjithashtu SNRF 9 dhe SNRF 15 në ose para datës së zbatimit të parë të SNRF 17. Ky standard nuk është i zbatueshëm për Shoqërinë.

Interpretimi i KIRFN 22 Transaksionet në valutë të huaj dhe konsiderata paraprake

Interpretimi sqaron se në përcaktimin e kursit të këmbimit të çastit për t'u përdorur në njohjen fillestare të aktivitetit, shpenzimeve ose të ardhurave (ose një pjese të tij) në lidhje me ç' regjistrimin e një aktivi jo-monetar ose detyrimi jomonetar që lidhet me shumën paraprake, data e transaksionit është data në të cilën një entitet fillimisht njeh aktivin jo-monetar ose detyrimin jomonetar që rrjedh nga shuma paraprake. Nëse ka pagesa të shumëfishta ose parapagime, atëherë entiteti duhet të përcaktojë datën e transaksionit për secilën pagesë ose marrje të konsideratës paraprake. Subjektet mund të aplikojnë ndryshimet në bazë të plotë retrospektive.

Ndryshe, subjekti mund të zbatojë Interpretimin në mënyrë prospektive për të gjitha aktivitetet, shpenzimet dhe të ardhurat në fushën e saj që njihen fillimisht në ose pas:

- i. Fillimi i periudhës raportuese në të cilën entiteti për herë të parë zbaton interpretimin, ose
- ii. Fillimi i një periudhe raportuese paraprake të paraqitur si informacion krahasues në pasqyrat financiare të periudhës raportuese në të cilën entiteti zbaton interpretimin e parë.

Interpretimi është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2018. Aplikimi i hershëm i interpretimit lejohet dhe duhet të raportohet. Megjithatë, meqenëse praktika e tanishme e Shoqërisë është në përputhje me Interpretimin, Shoqëria nuk pret ndonjë efekt në pasqyrat e saj financiare.

Interpretimi i KIRFN 23 Pasiguria mbi Trajtimin e Tatimit mbi të Ardhurat

Interpretimi trajton kontabilitetin për tatimin mbi të ardhurat kur trajtimet tatimore përfshijnë pasigurinë që ndikon në zbatimin e SNK 12 dhe nuk zbatohet për tatimet ose taksat jashtë fushëveprimit të SNK 12 dhe as nuk përfshin në mënyrë specifike kërkesat që lidhen me interesin dhe penalitetet në lidhje me trajtimin e pasigurt të tatimit. Interpretimi trajton në mënyrë specifike sa vijon:

- Nëse një entitet i konsideron trajtimet e pasigurta tatimore veç e veç;
- Supozimet që një entitet bën në lidhje me ekzaminimin e trajtimeve tatimore nga autoritetet tatimore;
- Si një entitet përcakton fitimin e tatueshëm (humbje tatimore), bazat tatimore, humbjet tatimore të papërdorura, kreditë tatimore të papërdorura dhe normat tatimore;
- Si një entitet i konsideron ndryshimet në fakte dhe rrethana.

Një entitet duhet të përcaktojë nëse duhet të konsiderojë çdo trajtim tatimor të pasigurt veçmas ose së bashku me një ose më shumë trajtime të tjera tatimore të pasigurta. Metodologjia që parashikon më mirë zgjidhjen e pasigurisë duhet të ndiqet. Interpretimi është efektiv për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019, por janë të disponueshme disa lehtësime të tranzicionit.

Shoqëria do të zbatojë interpretimin nga data e hyrjes në fuqi. Meqenëse Shoqëria vepron në një mjedis tatimor në ndryshim, zbatimi i Interpretimit mund të ndikojë në pasqyrat e saj financiare dhe në zbulimet e kërkuara.

5. Standarde të reja dhe amendimet (vazhdim)

5.1 Standarde dhe interpretime të publikuara që nuk janë ende të aplikueshme (vazhdim)

Interpretimi i KIRFN 23 Pasiguria mbi Trajtimin e Tatimit mbi të Ardhurat (vazhdim)

Përveç kësaj, Shoqëria mund të ketë nevojë të krijojë procese dhe procedura për të marrë informacionin që është i nevojshëm për të zbatuar Interpretimin në kohën e duhur.

Standartet e reja dhe përmirësimet e reja në vijim do të jenë efektive më ose pas 1 janar 2018, megjithatë nuk janë të aplikueshme për Shoqërinë:

- SNRF 2 Klasifikimi dhe matja e transaksioneve të pagesave të bazuara në aksione - Ndryshime në SNRF 2
- Aplikimi i SNRF 9 Instrumentat Financiarë me SNRF 4 Kontratat e Sigurimeve - Ndryshime në SNRF 4
- Ndryshimet në SNK 40 - Transfertat e Pronave të Investimit
- Interesat afatgjata në Shoqatë dhe Sipërmarrje të përbashkëta - Ndryshime në SNK 28
- Ndryshimet në SNRF 9 – Klasifikimi dhe Matja
- Ndryshimet në SNK 19 – Përfitimet e Punonjësve

Përmirësimet vjetore cikli 2014-2016 (të lëshuara në dhjetor 2016)

Këto përmirësime janë të aplikueshme për periudhat më apo pas 1 janar 2017. Përmirësimet e mëposhtme nuk janë të aplikueshme për Shoqërinë, dhe përfshijnë:

SNRF 1 Përshatja e parë e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar - Zhdukja e përjashtimeve afatshkurtra për përshtatjet e parë – në fuqi nga 1 janar 2018.

SNK 28 Investimet në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta - Sqarimi që matja e të investuarve me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes është një zgjedhje për investim pas investimi – në fuqi nga 1 janar 2018, lejohet aplikimi për periudhat e mëparshme.

SNRF 12 Publikimi i interesave në entitete të tjera - Ndryshimet hyjnë në fuqi nga 1 janari 2017 dhe duhet të zbatohen në mënyrë retrospektive.

Përmirësimet vjetore cikli 2015-2017 (të lëshuara në dhjetor 2017)

Këto përmirësime janë të aplikueshme për periudhat më apo pas 1 janar 2019. Këto përmirësime përfshijnë:

IFRS 3 Kombinimi I Biznesesve - Interesat e mbajtura më parë në një operacion të përbashkët.

SNRF 11 Marrëveshjet e Përbashkëta - Interesat e mbajtura më parë në një operacion të përbashkët.

SNK 12 Tatimi mbi të Ardhurat - Pasojat e tatimit mbi të ardhurat e pagesave të instrumenteve financiare të klasifikuara si kapital.

SNK 23 Kostot e Huamarrjes - Kostot e huamarrjes të pranueshme për kapitalizim.

ManeTCI SH.P.K.

Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2017
(të gjitha shumat janë të shprehura në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

6. Aktive afatgjata materiale

	Ndërtesa	Makinëri dhe paisje	Mjete transporti	Pajisje kompjuterike	Mobilje dhe pajisje të tjera	Te tjera	Totali
Kosto historike							
Gjendja më 01 janar 2016	51,325	66,046	93,198	21,200	33,888	6,045	271,702
Shtesa	-	4,831	34,028	3,588	13,878	2,578	58,903
Pakësime	-	(124)	(60)	(285)	(27)	(251)	(747)
Transferime	(51,325)	-	-	-	-	-	(51,325)
Gjendja më 31 dhjetor 2016	-	70,753	127,166	24,503	47,739	8,372	278,533
Shtesa	43,577	1,433	45,769	4,533	6,903	73	102,288
Pakësime	(10,231)	(28)	(5,834)	(494)	(1,937)	-	(18,524)
Transferime	-	1,392	(1,455)	-	-	-	(63)
Gjendja më 31 dhjetor 2017	33,346	73,550	165,646	28,542	52,705	8,445	362,234
Amortizimi i akumuluar							
Gjendja më 31 dhjetor 2015	-	(30,804)	(57,482)	(12,002)	(11,761)	(3,063)	(115,112)
Amortizimi i vitit	-	(7,368)	(13,037)	(2,613)	(5,342)	(845)	(29,205)
Pakësime	-	91	143	19	(100)	187	340
Gjendja më 31 dhjetor 2016	-	(38,081)	(70,376)	(14,596)	(17,203)	(3,721)	(143,977)
Amortizimi i vitit	(695)	(6,956)	(12,913)	(2,831)	(6,898)	(934)	(31,227)
Pakesime	-	22	4,545	424	1,141	-	6,132
Transferime	-	-	686	-	-	-	686
Gjendja më 31 dhjetor 2017	(695)	(45,015)	(78,058)	(17,003)	(22,960)	(4,655)	(168,387)
Vlera kontabël neto							
Gjendja më 31 dhjetor 2016	-	32,671	56,790	9,907	30,536	4,651	134,556
Gjendja më 31 dhjetor 2017	32,652	28,535	87,588	11,539	29,745	3,790	193,848

Me 31 dhjetor 2017 Shoqëria ka transferuar tre vila, të cilat janë dhene me qira operative, dhe një toke per qellime zhvillimi, nga aktive afatgjata materiale ne aktive afatgjata investimi. Shoqëria nuk ka asnjë barrë mbi aktivet afatgjata materiale ne datën e raportimit.

ManeTCI Sh.p.k.

Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
(të gjitha shumat janë të shprehura në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

7. Aktivët afatgjatë të investimit

Aktivët afatgjatë të investimit më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 janë si më poshtë:

	<u>Toka</u>	<u>Total</u>
Gjendja më 31 dhjetor 2016	-	-
Shtesa gjatë vitit (riklasifikim shenimi nr. 6)	42,901	42,901
Fitim nga rivlerësimi	104,386	104,386
Transferime	(147,287)	(147,287)
Gjendja më 31 dhjetor 2017	-	-

Shoqëria në Maj 2017 ka rregjistruar rivlerësimin e prones sipas aktit të rivlerësimit dhe studimit të tregut duke paguar detyrimet ligjore perkatëse dhe në dhjetor 2017 ka transferuar token për qëllime zhvillimi, nga aktive afatgjatë të investimit në inventar si rrjedhojë e krijimit të projekteve për ta zhvilluar ato.

8. Aksione dhe pjesëmarrje të tjera në njesitë e kontrolluara

Aksione dhe pjesëmarrje të tjera në njesitë e kontrolluara më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 janë si më poshtë:

	<u>% e Aksioneve</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>% e Aksioneve</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Tirana East Gate Shpk	91.095%	2,887,333	91.095%	2,887,333
Skenderbej Shpk	100,00%	52,559	100,00%	52,559
Mane TCI - Mane Xingang	51.00%	510	51.00%	510
Qendra Tregtare Univers	0.00%	-	100.00%	1,110,523
Totali		2,940,402		4,050,925

Më 18 tetor 2017 Shoqëria ka transferuar aksionet e kontrolluara në shoqërinë Qendra Tregtare Univers ("QTU") tek mëma Balfin shpk në kuadër të ristrukturimit të grupit.

9. Kredi me interes dhe huadhenje afatgjatë

Më 31 dhjetor 2017 vlera prej 35,941 mijë ALL perbehet nga dy kontrata huaje me interes të cilat Shoqëria i ka disbursuar në favor të paleve të treta (2016:0 ALL).

10. Aktive afatgjatë financiare, neto

Aktive afatgjatë financiare më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 janë si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Aktive afatgjatë financiare me palet e treta	584,969	204,325
Aktive afatgjatë financiare me kompanitë motra	57,496	24,337
Zhvlerësimi i aktiveve financiare me palet e treta	(146,157)	-
Totali	496,308	228,662

Shoqëria ka kryer një vlerësim të aktiveve afatgjatë financiare në lidhje me rikuperimin e plote të tyre duke zhvlerësuar të arketueshme nga palet e treta në shumën prej 146,157 mijë Lek.

Levizjet në provigjion më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 janë si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Gjendja në fillim të vitit	-	-
Shpenzimi vitit	(146,157)	-
Gjendja në fund të vitit	(146,157)	-

11. Inventari

Inventari në 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Produkte të gatshme	2,081,364	3,414,711
Punime në proces	1,790,192	716,891
Materiale	36,854	52,090
Inventari imet	1,147	984
Totali	3,909,557	4,184,676

ManeTCI Sh.p.k.

*Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
(të gjitha shumat janë të shprehura në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)*

11. Inventari (vazhdim)

Punime ne proces paraqet te gjitha kosot per investime ne proces per projektet e ndermarra nga Shoqeria si me poshte:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Afatshkurter		
Projekti Valamar	1,057,440	521,413
Projekte te tjera	444,531	10,781
Projekti Rolling Hills	-	184,697
Afatgjate		
Projekti Rolling Hills	288,221	-
Totali	<u>1,790,192</u>	<u>716,891</u>

Produket e gatshme perbehen nga projekte te perfunduara per te cilat Shoqeria nuk ka nje bleres te mundeshem ose kushtet e njohjes se shitjes nuk jane permbushur ende.

Shoqeria ne vitin 2017 ka vendosur si kolaterale inventar per njerën nga shoqerite motra ne vlerën 132,313 mijë Lek (2016: 357,405 mijë Lek).

Ndarja e inventarit ne afatgjate dhe afatshkurter kryet ne baze te parashikimit te Drejtimit te perfundimit te procesit te transferimit te pronës dhe liquidimit nga ana e klienteve. Per pjesen afatshkurter te inventarit, pergjithesisht egzistojne marreveshje te lidhura me klientet, te likuduara ne nje mase te konsiderueshme dhe ne pritje te perfundimit te transferimit te pronësise. Pronat e perfunduara dhe te gatshme per shitje jane gjithashtu afatshkurter ne baze te parashikimeve.

12. Kredi me interes dhe huadhenje afatshkurter

Kredi me interes dhe huadhenje afatshkurter më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 janë si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Ndaj paleve te treta	374,680	2,028
